



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M K.P.P. 127/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.03.2019 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

- Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kastrati” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-01680-12-25-2018, me objekt, “*Blerje karburant (Naftë) për nevojat e Bashkisë Dibër, për vitin 2019*”, me fond limit 10.833.333 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 18.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.”
- Ankimues:** “Doda Ndërtim” sh.p.k.
Dibër, Peshkopi
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Dibër
Bulevardi “Elez Isufi”, Peshkopi
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.12.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-01680-12-25-2018, me objekt, “Blerje karburant (Naftë) për nevojat e Bashkisë Dibër, për vitin 2019”, me fond limit 10.833.333 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 18.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

II.2. Në datën 18.01.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në

datë 22.01.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Kastrati” sh.p.k. 7.8 % marzhi i fitimit, kualifikuar
2. “Gega Center GKG” sh.p.k. 10 % marzhi i fitimit, skualifikuar
3. “Doda Ndërtim” sh.p.k. 14 % marzhi i fitimit, kualifikuar

II.4. Operatori ekonomik “Doda Ndërtim” sh.p.k. në datën 28.01.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kastrati” sh.p.k., me pretendimet si më poshtë vijon:

[...] Bazuar në të drejtën që i jep ligji i LPP-së dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014, operatori “Doda Ndërtim” sh.p.k. ka lexuar kriteret e vendosura në pikat 2.3.2 deri 2.3.8 (kriteret e vecanta të kualifikimit kapaciteti teknik). Pas leximit të kriterëve të vecanta të vendosura nga AK Bashkia Dibër, konstatoam që këto kritere nuk janë të përputhura sipas rregullave të përcaktuara në LPP dhe VKM 914. Këtë pretendim të ngritur nga ana jonë e argumentojmë me sqarimet e mëposhtme të mbështetura në LPP dhe VKM 914.

Pika 1: Në pikën 2.3/7 të DST-ve kërkohet “Malli duhet të jetë i shoqëruar me fletëanalizë nga autoritetet përkatëse për sa i përket cilësisë”. OE Doda Ndërtim sh.p.k. ka paraqitur fletëanalizën përkatëse me elementët e përshkrimit se ku është marrë kampioni i analizës, për pikën e karburantit me adresë Kuben, Pilafe, Dibër me nr. Pasurie 175/35 e cila është edhe pika e karburantit e kërkuar sipas DST0ve. Ndersa subjekti Kastrati sha ka mare pjese ne proceduren me piken e karburantit te stacionuar ne aksin Peshkopi-Maqellare ndersa flete analiza e kerkuar ne DST e ka paraqitur per nje pike tjeter karburanti e cila nuk eshte e Prefektures Dibër, por e prefekturës Durres, perkatesisht flete analiza e shkarkimit te lengut ne portin e Durresit ne momentin qe malli hyn ne dogane. Pasi ne flete analizen e leshuar nga Inspektoriat Shteteror Teknik dhe Industrial, DLQK, Kontrolli i naftes dhe gazit percaktohen perkatesisht te dhenat e subjektit ku eshte marre analiza e lengut, vendmarrja e mostres, sasia e produktit/mostres se marre, Kodi, Data e marrjes se mostres, data e mberritjes se mostres, data e pergjigjes dhe Prefektura. Subjekti Kastrati shpk nuk ka paraqitur flete analize per piken e shitjes se karburantit me adrese aksi Peshkopi-Maqellare. Për këtë arsye kërkohet skualifikimin e OE Kastrati sh.p.k. nga procedura e prokurimit nga ana e AK Bashkia Dibër dhe kualifikimin e ofertës tonë pasi është e vetmja ofertë që i përmbush kriteret e kërkuara në DST.

II.5. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor si dhe dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së operatorit ekonomik ankimes, autoriteti kontraktor në datën 31.01.2019, me anë të shkresës nr.363/1 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes duke e refuzuar ankesën e tij. Ndër të tjera, autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes ka argumentuar:

“[...] Pas verifikimit te bere nga ana jone rezuton se OE Kastrati shpk, me NIPT JxxxxxxxP, me adrese: Durres, Lagja 14, Rruga Tirana, prane Gjykates se Apelit Shkozet, ka marre pjese me oferten e tij ne proceduren objekt ankimi dhe nder te tjera ne permbushje te kriterëve te kerkuara nga AK Bashkia Diber ne DST te procedures ne fjale, konkretisht ne permbushje te kriterit 2.3/7 te DST-ku citohet "Malli duhet te jete i shoqeruar me fleteanalize nga Autoritet perkatese sa i perket cilesise" OE KASTRATI shpk ka dorezuar ne Sistemin Elektronik te Prokurimeve (SPE)

dokumentin "RAPORT ANALIZIMI PER TREGUN E BRENDSEHEM" me te dhena: Subjekti Kastrati shpk, Vendmarrja: API P03 P12, Sasia: 3000L, Kodi: 356010, Data e marrjes se mostres: 08.01.2019, Data e mberrijtes se mostres: 09.01.2019, Data e pergjigjes: 09.01.2019, Prefektura: Tirane, leshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial, Drejtoria e Laboratorit Qendror te Kontrollit, Laboratori i Kontrollit te Naftes dhe Gazit, dokument i cili bazuar ne Ligjin "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe ne zbatim te VKM Nr 914 dt. 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", I ndryshuar si dhe bazuar ne: Ekstraktin historik te OE KASTRATI shpk, Deklarate Furnizimi me Karburant nga OE KASTRATI shpk date 18.01.2019, ku citohet Shoqeria Kastrati shpk disponon 2(dy) stacione te shitjes me pakice te karburanteve, te cilat jane ne pronesi te shoqerise Kastrati shpk dhe te pasqyruara ne Ekstraktin tregtar te QKB se, brenda territorit te Bashkise Diber dhe nderkohe ka depozituar dokumentacion pronesie per njeren nga pikat e shitjes se karburantit perkatesisht ate me adrese aksi Peshkopi-Maqellare, ne perputhje me kerkesat e vendosura nga AK ne DST, kjo e ngarkuar ne (SPE), Ligjin Nr. 71/2014, Per Disa Shtesa Dhe Ndryshime Ne Ligjin Nr 8450, Date 24.2.1999, "Per Perpunimin, Transportimin Dhe Tregtimin E Naftes, Gazit Dhe Nenprodukteve Te Tyre", te ndryshuar, Urdherin Nr. 6, date 09.01.2015, te Ministrise se Energjise dhe Industrise "Per Kontrollin e standareteve teknike te naftes dhe nenprodukteve te saj, procedurat dhe tarifa perkatese", paragrafi II, pika 2 ku citohet: Marrja e monstres behet per naften bruato dhe nenproduktet e saj per sasite e prodhuara ne vend, sasite e importuara para zhdoganimit. Sa me siper ndryshe nga sa ju pretendoni dokumenti "Raport Analizimi Per Tregun e Brendshem", i paraqitur ne (SPE) nga OE Kastrati shpk, eshte ne perputhje te plote me kriterin e vendosur nga AK Bashkia Diber perkatesisht kriteri 2.3/7 te DST-ku citohet "Malli duhet te jete i shoqeruar me fleteanalize nga Autoritet perkatese sa i perket cilesise", pasi OE ne fjale ka ofertuar si i vetem dhe pika e shitjes se karburantit me adrese aksi Peshkopi-Maqellare, rezulton te jete ne listen e pikave te shitjes e perfshire ne Ekstraktin historik te OE Kastrati shpk si dhe ne Deklaraten Furnizimit me Karburant nga OE Kastrati shpk date 18.01.2019 kjo e ngarkuar ne(SPE). Ne keto kushte pretendimi juaj se subjekti Kastrati shpk nuk ka paraqitur fleteanalize per piken e shitjes se karburantit me adrese aksi Peshkopi-Maqellare nuk gjen mbeshtetje ligjore pasi kemi te bejme me nje subjekt te vetem I cili ne permbushje te te gjitha kriterëve te vendosura nga AK Bashkia Diber ka dorezuar te gjithë dokumentacionin e kerkuar. Sa me super pretendimi i akimuesit nuk qendron. [...]

II.6. Në datën 05.02.2019 operatori ekonomik "Doda Ndërtim" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...] Në pikën 2.3/7 të DST-ve kërkohet "Malli duhet të jetë i shoqëruar me fletëanalizë nga autoritetet përkatëse për sa i përket cilësisë". OE Doda Ndërtim sh.p.k. ka paraqitur fletëanalizën përkatëse me elementët e përshkrimit se ku është marrë kampioni i analizës, për pikën e karburantit me adresë Kuben, Pilafe, Dibër me nr. Pasurie 175/35 e cila është edhe pika e karburantit e kërkuar sipas DST0ve. Ndersa subjekti Kastrati sha ka mare pjese ne proceduren me piken e karburantit te stacionuar ne aksin Peshkopi-Maqellare ndersa flete analiza e kerkuar ne DST e ka paraqitur per nje pike tjeter karburanti e cila nuk eshte e Prefektures Dibër, por e prefekturës Durrës, perkatesisht flete analiza e shkarkimit te lengut ne portin e Durrësit ne momentin qe malli hyn ne dogane. Pasi ne flete analizen e leshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial , DLQK, Kontrolli i naftes dhe gazit percaktohen perkatesisht te dhenat e subjektit ku eshte marre analiza e lengut, vendmarrja e mostres, sasia e produktit/mostres se marre, Kodi, Data e marrjes

se mostres, data e mberritjes se mostres, data e pergjigjes dhe Prefektura. Subjekti Kastrati shpk nuk ka paraqitur flete analize per piken e shitjes se karburantit me adrese aksi Peshkopi-Maqellare. Për këtë arsye kërkohet skualifikimin e OE Kastrati sh.p.k. nga procedura e prokurimit nga ana e AK Bashkia Dibër dhe kualifikimin e ofertës tonë pasi është e vetmja ofertë që i përmbush kriteret e kërkuara në DST.

II.7. Njëpërmjet shkresës nr. 585/1 prot., datë 18.02.2019, protokolluar me tonën në datën 18.02.2019, me objekt “Dërgim informacioni në lidhje me vendimin tuaj nr. 164/1 prot, datë 11.02.2019” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Doda Ndërtim” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kastrati” sh.p.k. me pretendimin se “...subjekti Kastrati sha ka mare pjese ne proceduren me piken e karburantit te stacionuar ne aksin Peshkopi-Maqellare ndersa flete analiza e kerkuar ne DST e ka paraqitur per nje pike tjeter karburanti e cila nuk eshte e Prefektures Dibër, por e prefekturës Durrës, perkatesisht flete analiza e shkarkimit te lengut ne portin e Durrësit ne momentin qe malli hyn ne dogane. Pasi ne flete analizen e leshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial, DLQK, Kontrolli i naftes dhe gazit percaktohen perkatesisht te dhenat e subjektit ku eshte marre analiza e lengut, vendmarrja e mostres, sasia e produktit/mostres se marre, Kodi, Data e marrjes se mostres, data e mberritjes se mostres, data e pergjigjes dhe Prefektura. Subjekti Kastrati shpk nuk ka paraqitur flete analize per piken e shitjes se karburantit me adrese aksi Peshkopi-Maqellare. Për këtë arsye kërkohet skualifikimin e OE Kastrati sh.p.k. nga procedura e prokurimit nga ana e AK Bashkia Dibër dhe kualifikimin e ofertës tonë pasi është e vetmja ofertë që i përmbush kriteret e kërkuara në DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.7 e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “2.3/7 Malli duhet te jete i shoqeruar me fleteanalize nga Autoritetet perketese sa i perket cilesise.”

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Kastrati” sh.p.k., , rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Raport Analizimi për Tregun e Brendshëm “Gazoil standard S SH EN 590:2013/A1:2017”, me Nr.5/1 prot., datë 10.01.2019, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/a e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;[...]*”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .*”

III.1.4. Në nenin 27, pika 6/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “*Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*”

III.1.5. Ndërsa në nenin 27 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*”.

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që malli që do të dorëzohet nga operatori ekonomik, i cili do të fitojë kontratën, të jetë i shoqëruar me fletëanalizën nga autoriteti përkatës.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kastrati” sh.p.k. me argumentin se ky i fundit nuk ka paraqitur fletëanalizën e produktit të kërkuar për pikën e shitjes së karburantit me adresë aksi Peshkopi-Maqellarë, por ka paraqitur fletëanalizë për një adresë tjetër, KPP sqaron se, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.7 “*Kapaciteti teknik*”, të dokumentave të tenderit ka përcaktuar shprehimisht se “*Malli duhet të jetë i shoqëruar me*

fletëanalize nga Autoritetet përkatëse sa i përket cilësisë”. Në një interpretim literal të kriterit të mësipërm, konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesën për dorëzimin e fletëanalizës së mallit në momentin e dorëzimit të mallit dhe jo në momentin e dorëzimit të ofertave. Pra, sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kastrati” sh.p.k. është një pretendim i cili bazohet mbi një kriter të pakërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, pasi përmbushja e kriterit të mësipërm është kërkuar nga AK në momentin e dorëzimit të mallit, dhe jo në fazën e hapjes së ofertave.

Akoma më tej, referuar kriterit të mësipërm si dhe pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se fletëanaliza e cilësisë për produktin e kërkuar duhet të lëshohet nga autoritetet përkatëse, por nuk ka përcaktuar vendndodhje specifike të produktit nga i cili duhet marrë kjo analizë. Pra, në asnjë moment nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar dhe përcaktuar fakti që fletëanaliza e cilësisë së produktit të paraqitet specifikisht për produktin në pikën e shitjes me adresë Peshkopi-Maqellare, siç pretendon operatori ekonomik ankimues.

Sa më sipër, operatori ekonomik ankimues, ka ngritur pretendime mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Kastrati” sh.p.k. mbi një kriter i cili nuk është kërkuar nga autoriteti kontraktor, kështu që rrjedhimisht kërkesa e tij është një kërkesë e pabazuar dhe nuk qëndron.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni*”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Doda Ndërtim” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-01680-12-25-2018, me objekt, “*Blerje karburant (Naftë) për nevojat e Bashkisë Dibër, për vitin 2019*”, me fond limit 10.833.333 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 18.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 164 Protokoll

Datë 05.02.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha